


# TaxNews

Korrik 2019  
July 2019



**Deloitte.**

## I. Detyrimi i tatimpaguesve për hapjen llogarive bankare dhe deklarimin e tyre pranë administratës tatimore

Në Fletoren Zyrtare nr. 99, datë 10.07.2019 është publikuar Ligji nr. 31/2019, datë 17.06.2019 "Për disa shtesa në Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 'Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë', të ndryshuar".

Qëllimi i shtesave të parashikuara në këtë ligj është formalizimi dhe reduktimi i përdorimit të parasë fizike dhe reduktimi i ekonomisë informale.

Ligji parashikon se tatimpaguesit:

- persona fizikë tregtarë, të regjistruar për TVSH-në;
- persona juridikë pavarësisht nga qarkullimi që realizojnë; si dhe,
- organizatat jofitimprurëse të regjistruara pranë administratës tatimore,

kanë detyrimin të kenë llogari bankare dhe ta deklarojnë atë pranë administratës tatimore.

### ● Afatet ligjore

Tatimpaguesit, të cilët regjistrohen rishtazi kanë detyrimin të kenë llogari bankare të biznesit/organizatës dhe ta deklarojnë atë pranë administratës tatimore, jo më vonë se 20 ditë kalendarike duke filluar nga e nesërmja e ditës së regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit/administratën tatimore.

Ndërsa, tatimpaguesit të regjistruar tashmë në Qendrën Kombëtare të Biznesit/administratën tatimore në momentin e hyrjes në fuqi të këtij ligji (25.07.2019), kanë detyrimin të hapin dhe deklarojnë llogaritë bankare jo më vonë se 90 ditë nga hyrja në fuqi e këtij ligji, pra jo më vonë se data 23.10.2019.

## I. Obligation of taxpayers to open bank accounts and declare them to the tax administration

In the Official Gazette no. 99, dated 10.07.2019 is published the Law no. 31/2019, dated 17.06.2019 "On some additions to the Law no. 9920, dated 19.05.2008 'On tax procedures in the Republic of Albania', as amended".

The purpose of the additions provided in this law is the formalization and reduction of cash use and the reduction of informal economy.

The law provides that taxpayers:

- commercial physical persons, registered for VAT;
- legal entities regardless of their annual turnover; as well as,
- non-for-profit organizations registered with the tax administration,

have the obligation to open business bank accounts and declare them to the tax administration.

### ● Legal deadlines

Newly registered taxpayers are required to have a business/organization bank account and declare it with the tax administration no later than 20 calendar days starting from the day after the registration at the National Business Center/tax administration.

Whereas, taxpayers already registered to the National Business Center/tax administration at the time of entry into force of this law (25.07.2019), are obliged to open and declare their bank accounts no later than 90 days after the entry into force of this law. i.e. no later than 23.10.2019.

## ● Sanksionet

Ligji parashikon sanksionet e mëposhtme për tatimpaguesit që nuk përmbushin detyrimin për hapjen e llogarive bankare dhe deklarimin e tyre pranë administratës tatimore:

- a) Personat fizikë tregtarë, të regjistruar për TVSH-në dhe që kanë qarkullim deri në 8 milionë lekë, dënohen me gjobë në shumën 25,000 lekë;
- b) Personat juridikë, pavarësisht nga qarkullimi dhe tatimpaguesit persona fizikë tregtarë me qarkullim mbi 8 milionë lekë, dënohen me gjobë deri në shumën 50,000 lekë;
- c) Organizatat jofitimprurëse dënohen me gjobë në shumën 37,000 lekë.

Nëse edhe pas zbatimit të sanksioneve të lartpërmendura nuk përmbushet detyrimi për hapjen dhe deklarimin e llogarive bankare të biznesit pranë administratës tatimore, tatimpaguesit dënohen me dyfishin e gjobës së parë të zbatuar.

## II. Ratifikimi i marrëveshjes për shmangien e tatimit të dyfishtë dhe parandalimin e evazionit fiskal në lidhje me tatimin mbi të ardhurat dhe kapitalin midis Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Arabisë Saudite

Në Fletoren Zyrtare nr. 103, datë 17.07.2019 është publikuar Ligji nr. 40/2019 "Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Arabisë Saudite për Shmangien e tatimit të dyfishtë dhe parandalimin e evazionit fiskal në lidhje me tatimin mbi të ardhurat dhe kapitalin".

## ● Penalties

The law provides for the following sanctions for taxpayers that do not comply with the obligation to open and declare their bank accounts with the tax administration:

- a) Commercial physical persons, registered for VAT, whose annual turnover is up to ALL 8 million are subject of penalty amounting to ALL 25,000;
- b) Legal entities, regardless of their annual turnover and commercial physical persons with an annual turnover above ALL 8 million are subject of penalty amounting to ALL 50,000;
- c) Non-for-profit organizations are subject of penalty amounting to ALL 37,000.

If the obligation to open and declare the business bank accounts with the tax administration is not fulfilled even after the aforementioned sanctions are applied, taxpayers will be penalized twice as much as the first applied penalty.

## II. Ratification of the agreement on avoidance of double taxation and prevention of tax evasion with regards to taxes on income and capital between the Republic of Albania and the Kingdom of Saudi Arabia

In the Official Gazette no. 103, dated 17.07.2019 is published the Law no. 40/2019 "On the ratification of the agreement between the Republic of Albania and the Kingdom of Saudi Arabia on avoidance of double taxation and prevention of tax evasion with regards to taxes on income and capital".

Kjo marrëveshje do të hyjë në fuqi pas përfundimit të procedurave që kërkohen nga ligjet e secilit prej shteteve respektive për hyrjen në fuqi të saj dhe njoftimit të tyre.

### **III. Ratifikimi i marrëveshjes me OECD-në për bërjen palë të Shqipërisë në projektin BEPS të OECD/G20**

Në Fletoren Zyrtare nr. 99, datë 10.07.2019 është publikuar Ligji nr. 35/2019, datë 17.06.2019 nëpërmjet të cilit ratifikohet marrëveshja me shkëmbim notash ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Organizatës për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD) për bërjen palë në kuadrin gjithëpërfshirës të projektit ndërkombëtar mbi erozionin e bazës së tatueshme dhe transferimin e fitimit (BEPS). Përmes kësaj marrëveshjeje, qeveria shqiptare bie dakord të zbatojë masat e propozuara të projektit BEPS të OECD/G20 me qëllim reduktimin e mundësisë për shmangie tatimore nga shoqëritë ndërkombëtare.

This Agreement shall enter into force after the completion of the procedures required by the laws of each respective State regarding its entry into force and their notification.

### **III. Ratification of the convention with OECD on the Republic of Albania becoming a party to OECD/G20 BEPS project**

In the Official Gazette no. 99, dated 10.07.2019 it is published Law no. 35/2019, dated 17.06.2019, through which the convention with note exchange between the Republic of Albania and the Organization for Economic Cooperation and Development (OECD) on becoming party to the comprehensive framework of the international project on base erosion and profit shifting (BEPS). Through this convention, the Albanian government agrees to implement measures proposed by the OECD/G20 BEPS project with the purpose of reducing opportunities for tax avoidance from multinational companies.

## Deloitte Contacts

### **Olindo Shehu, CPA**

Partner | Tax & Legal Services

Deloitte Albania sh.p.k

Rr. "Elbasanit", Pallati prane Fakultetit

Gjeologji Miniera

Tirana | Albania

Mob: +355 68 60 33 116

E-mail: [oshehu@deloitteCE.com](mailto:oshehu@deloitteCE.com)

### **Disclaimer:**

This publication contains general information only, and none of Deloitte Touché Tohmatsu Limited, any of its member firms or any of the foregoing's affiliates (collectively the "Deloitte Network") are, by means of this publication, rendering accounting, business, financial, investment, legal, tax, or other professional advice or services.

This publication is not a substitute for such professional advice or services, nor should it be used as a basis for any decision or action that may affect your finances or your business. Before making any decision or taking any action that may affect your finances or your business, you should consult a qualified professional adviser. No entity in the Deloitte Network shall be responsible for any loss whatsoever sustained by any person who relies on this publication.

No entity in the Deloitte Network shall be responsible for any loss whatsoever sustained by any person who relies on this publication.

\*\*\*

Deloitte refers to one or more of Deloitte Touché Tohmatsu Limited, a UK private company limited by guarantee, and its network of member firms, each of which is a legally separate and independent entity. Please see [www.deloitte.com/al/about](http://www.deloitte.com/al/about) for a detailed description of the legal structure of Deloitte Touché Tohmatsu Limited and its member firms.

Deloitte provides audit, tax, consulting, and financial advisory services to public and private clients spanning multiple industries. With a globally connected network of member firms in more than 150 countries, Deloitte brings world-class capabilities and deep local expertise to help clients succeed wherever they operate. Deloitte's approximately 290,000 professionals are committed to becoming the standard of excellence.